




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPALITY OF GJILAN/GILAN  
BELEDIYESI



---

Drejtoria për Rini, Kulturë dhe Sport

---

Rregullore  
për

Fuqizimin dhe promovimin e vullnetarizmit në Komunë

Në bazë të nenit 11, 12.2 shkronja c) dhe nenit 17 shkronja r) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës se Kosovës”, 28/2008), dhe ne zbatim të Ligjit nr. 03/L-145 për Fuqizimin dhe Pjesmarrje të Rinisë nen 14, dhe në pajtim me dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr.10/2010 për punën vullnetare të të rinjëve, nenit \_\_\_\_\_ të Statutit të Komunës së \_\_\_\_\_, nr.\_\_\_\_\_ të datës\_\_\_\_\_, Kuvendi Komunës së\_\_\_\_\_, me \_\_\_\_ miraton këtë:

**Rregullore**  
**Për Fuqizimin dhe promovimin e**  
**vullnetarizmit në Komunë**

**Neni 1**  
**1. Dispozitat e përgjithëshme**

**Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është rregullimi dhe fuqizimi i vullnetarizmit, i marrëdhënieve që krijohen midis vullnetarëve dhe subjektit juridik organizator të vullnetarizmit, për nxitjen dhe zhvillimin e vullnetarizmit në Komunë.

**Neni 2**  
**Fusha e Zbatimit**

1. Kjo rregullore, rregullon **punën vullnetare e të rinjëve në komunë**, ku terminologja bazë e punës vullnetare, principet dhe termat rregullohen si të drejta dhe obligime të vullnetarëve dhe të subjekteve organizatore të vullnetarizmit, kushte për formulimin e kontratave të vullnetarizmit dhe kodeve etike, lëshim i certifikatave të vullnetarizmit, vlerësim me çmim për vullnetarizmin dhe garantim i implementimit të kësaj rregulloreje.
2. Kjo rregullore trajton të gjitha llojet e marrëdhënieve midis vullnetarëve dhe subjekteve organizatore të vullnetarizmit, gjatë kryerjes së aktivitetave jofitimprurëse në dobi të një individi tjetër apo të publikut të gjerë.
3. Kjo rregullore aplikohet tek shërbimet dhe aktivitetet **komunale**, realizimi i të cilave organizohet në mënyrat që rregullon Kjo rregullore.

**Neni 3**  
**Përkufizime**

Përkufizime:

1. Në këtë rregullore përkufizimet e mesposhtme kanë këto kuptime:

- 1.1.** **Vullnetar** – nënkuption atë siq është përcaktuar në ligj dhe udhëzim administrativ, gjegjësisht, është një individ i cili investon kohë, përpjekje, njojuri apo aftësi vetjake me vullnetin e tij të lirë, në shërbim të aktiviteteve dhe veprimtarive të kryera me qëllim mirëqënien e një individu tjetër apo të publikut të gjerë, që zhvillohen sipas mënyrës që parashikon Kjo rregullore, pa kërkuar në shkëmbim asnjë formë shpërbimi financiar apo material për vullnetarizmin e kryer. Një vullnetar është çdo individ që zotëron një aftësi për punë dhe është vullnetar në Komunë.
- 1.2.** **Vullnetar minoren** është një vullnetar i ri nën moshën 16 vjeç i cili kryen punë vullnetare në Komunë.
- 1.3.** **Konratë Vullnetarizmi** – Konratë e lidhur me vullnet të lire, midis subjekteve organizatore të vullnetarizmit dhe vullnetarëve, për zhvillimin e aktiviteteve apo veprimtarive jofitimprurëse në dobi të një individu tjetër apo të publikut të gjerë.
- 1.4.** **Mentor** – është individu lider i cili e bënë monitorimin e punës dhe këshillimin e vullnetarit – grupit të vullnetarëve.
- 1.5.** Përveq përkufizimeve të përcaktuara me këtë rregullore do të shërbejnë edhe përkufizimet e përcaktuara ne udhëzimin administrativ për punën vullnetare të të rinjëve.

#### **Neni**

#### **Përfitimet e komunës nga puna vullnetare**

1. Nxitja e qytetarisë aktive;
2. Ndihmon komunënë në realizimin e projekteve në interes publik;
3. promovimin dhe fuqizimin e vlerave e të rinjve në komunë;
4. permisimi i mirqenjes se qytetarve.
5. forcon bashkëpunimin dhe besimin në mes qytetarve dhe komunës.
6. ndihmon komunën në realizimin e interesave të tjera për komunën.
7. ndihmon komunën në afirmimin e saje në procesin e integrimit;
8. ndihmon integrimin e të rinjeve brenda komuniteteve.

#### **Neni 4**

#### **Promovimi**

1. Vullnetarizmi njihet dhe promovohet si një aktivitet i një interesi të veçantë për Komunën, për aq sa përmirëson cilësinë e jetës, stimulon pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në jetën shoqërore dhe kontribuon në zhvillimin e një shoqërie më të barabartë, humane dhe më demokratike.
2. Roli i vullnetarizmit dhe rëndësia e tij duhet të përcillen tek fëmijët dhe të rinjtë nëpërmjet aktiviteteve jashtë arsimore në shkollimin e ulët dhe të mesëm. Kjo duhet të përcillet me aktivitet praktik duke i angazhuar nxënësit në punë të dobishme shoqërore.

#### **Neni 5**

#### **Punët të cilat nuk trajtohen si punë vullnetare**

- (1) Referuar kësaj rregulloreje, nuk konsiderohet vullnetarizëm si më poshtë:
- Kryerja e aktiviteteve vullnetare ose ofrimi i shërbimeve që nuk janë në përputhje me ligjin dhe aktet tjera nënligjore.

- zhvillimi i aktiviteteve ose ofrimi i shërbimeve kundrejt përfitimit finansiar apo material të parregulluar nga kontrata të rregullta sipas ligjit të Punës
- Kryerja e punëve pa shëprblim natyra e së cilave i përket një marëdhënie punësimi e cila rregullohet me ligjin e Punës
- Kryerjen e punëve ose ofrimi i shërbimeve që njëra palë është e detyruar të kryejë për palë të treta siç përcaktohet me ligj apo akte nënligjore
- Përbushjen e detyrimeve dhe kryerjen e aktiviteteve që një individ është i detyruar ti zhvillojë për një palë të tretë të përcaktuar me ligj apo rregulloret tjera
- Zbatimit të detyrimeve të veçanta në përputhje me vendim gjykate,
- Kryerja e veprimtarive ose shërbimeve që janë për përfitim të rrethit familjar apo miqësor.

### **Neni 6**

Puna vullnetare në Komunë bëhet për interes publik.

### **Neni 7**

#### **Trajtimi i vullnetarëve**

1. Organizatori punës vullnetare në komunë është i detyruar për të trajtuar vullnetarë në bazë të parimit të mundësive të barabarta për të gjithë, pavarësisht moshës, racës, gjuhës, fesë, gjinisë, orientimit seksual, bindjeve politike apo të besimit, përkatësisë nationale apo sociale, gjendjes financiare, arsimit, pozitës shoqërore, gjendjes civile, përgjegjësive familjare, apo anëtarësimit ose joanëtarësimit në një parti etj, aftësive fizike ose mendore, sëmundjeve etj.
2. **Aktivitetet lidhur me punët vullnetare që i zhvillojnë partitë politike nuk trajtohen me këtë rregullore.**

### **Neni 8**

#### **Drejtoria për Rini, Kulturë dhe Sport dhe mentorë**

##### **1. Drejtorati për Rini, Kulturë dhe Sport** është përgjegjës:

- 1.1. të mbaj regjistrin e vullnetarëve të pranuara nga organizatori i punës vullnetare,
- 1.2. ti përcjell regjistrat e vullnetarëve në nivel qendror – Departamentin e rinisë,
- 1.3. pranon kërkesat nga organizuesit e punës vullnetare për pajisje me librezë vullnetare,
- 1.4. shqyrton kërkesat dhe dokumentacionin tjetër përkatës dhe vendos që të lëshojë nga një librezë për selicilin vullnetar të paraqitur,
- 1.5. të përcjell ndryshimet eventuale në statusin dhe marrëveshjen e vullnetarit dhe kujdeset që këto ndryshime të janë në pajtim me këtë rregullore dhe ligj.
- 1.6. bënë verifikimin e të dhënavës në libresa të pranuara nga organizatori pas përfundimit të punës vullnetare se të njejtat a janë të plotësuara në pajtim me udhëzimet ligjore dhe marrëveshjen në mes organizuesit të punës vullnetare dhe vullnetarit,
- 1.7. bënë vërtetimin e librezave duke i vulosur,
- 1.8. kryen edhe punë tjera që lidhen me aktivitetin e punës vullnetare në Komunë e që nuk bie ndesh me ligjin dhe aktet tjera nënligjore.

### **Neni 9**

##### **1. Mentorë** është përgjegjës:

bënë koordinimin e punëve bashkë me vullnetarin - vullnetarët  
bënë përcaktimin e objektivave të aktivitetit për zhvillimin e punës vullnetare;  
për monitorimin e punës dhe këshillimin e vullnetarit – grupit të vullnetarëve,  
bënë raport për zhvillimin e punës nga ana vullnetarit, ku përfshinë orët vullnetare të mbajtura, sfidat gjatë kryerjes së punës vullnetre, trajnimet që janë propozuar në mes vullnetarit dhe mentorit, efektet e arritura të cilat do të maten nga përfomanca në punë, aftësit e veçanta që janë treguar nga vullnetari,  
kryen edhe detyrat tjera të përcaktuara me ligj dhe akte nenligjore.

### **Neni 10**

1. Kriteret dhe kushtet të cilat duhet ti plotësoj një mentor duhet ti caktoj organizuesi i punës vullnetare.
2. Mentor duhet të ketë vlera morale dhe përvoj relevante.

### **Neni 11** **Obligimet e vullnetarëve**

Obligimet e vullnetarëve janë ato të cilat janë të përcaktuara me udhëzim administrativ.

### **Neni 12** **Lidhja e marrëveshjes për punë vullnetare**

Lidhja e marrëveshjes për punë vullnetare bëhet në pajtim me udhëzimin administrativ.

### **Neni 13** **Kompensimi i dëmit**

Kompenzimi i dëmit caktohet në pajtim me dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore që e rregullojnë këtë fushë.

### **Neni 14** **Përfundimi i punës vullnetare**

Përfundimi i punës vullnetare bëhet në pajtim me dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore që e rregullojnë këtë fushë.

### **Neni 15** **Motivimi i vullnetarëve**

1. Hyrje pa pagesë në ndeshjet sportive që luhen në Stadiumin e Qyetetit dhe në Plestrën e Sporteve “Bashkim Selishta - Petriti” në Gjilan.
2. Hyrje pa pagesë në shfaqjet teatrale të cilat shfaqen në Teatrin e Qytetit në Gjilan.
3. Regjistrim pa pagesë në Bibliotekën Rajonale “Fan S. Noli” në Gjilan.
4. Konsiderimi i punës vullnetare si përparësi në kriteret vlerësuese me rastin e punësimeve në kuadër të institacioneve komunale.

5. përparsi ne përfitimin e bursave;
6. përparsi në shërbimet publike komunale;
7. përparsi në pjesëmarrje në trajnime;
8. të deret të shfrytëzimin e objekteve publike për aktivitete e organizatave vullnetare;
9. ndarja e shpërblimeve për punen vullnetare;
10. promovimi i rezultateve nga puna vullnetare në mjetet publike për publikim (Ueb.faqe, etj, gazeta, revista, fletpalosje);
11. organizimi i aktiviteteve kulturore për vullnetar;
12. përfshirja e vullnetarve në organizimin e aktiviteteve kulturore të organizuar nga komuna;
13. ofrimi i mundësive për kryerjen e punes praktike në insituconet publike-administrat komunale;
14. organizimi i fushatës promovuese të vullnetarizmit.

**Neni 16**

**Integrimi i punës vullnetare-brenda planit te veprimi**

1. aktivitetet e punes vullnetare duhet të jenë pjesë e planit të punës, planit të veprimit dhe qdo dokumenti tjetër të Drejtorisë përgjegjëse për rini.

**Neni 17**

**Vullnetarizmi brenda KVRL dhe qendrave rinore**

Aktivitetet e kryera ose shërbimet e ofruara nga KVRL dhe Qendra rinore që veprojnë brenda komunës parim kryesor do të kenë punën vullnetare nëpërmjet së cilës bëjnë ngritjen e vetëdijes për punë vullnetare të anëtarëve të saj.

**Neni 18**

**baza e të dhënave**

Drejtoria për Rini, Kulturë dhe Sport e ndihmuar ka obligim që te mbaj bazën e të dhënave me qëllim të monitorimit të punës vullnetare në punë;

**Neni 19**

**Buxhetit**

Aktivitetet e punës vullnetare duhet të jenë pjes e planifikimeve buxhetore komunale;

**Neni 20**

**Puna vullnetare gjat procesit mësimor**

Aktivitetet e punës vullnetare nuk mund ti përcjellin nxënësit gjatë procesit mësimor.

**Neni 21**

**Mbikëqyrja**

Mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj rregulloreje e bënë Kryetari i Komunës kurse zbatimin e saj e bënë Drejtoria përkatëse.

**Neni 22**  
**2. Dispozitat përfundimtare**

Aspektet e vullnetarizmit të rregulluara me këtë rregullore, si dhe marrëdhënet që lindin nga kontrata e vullnetarizmit që nuk janë të përcaktuara me këtë rregullore janë objekt i dispozitave të përgjithshme ligjore.

**Neni 23**

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së \_\_\_\_\_.

01. nr. \_\_\_\_\_

Kryesuesi i Kuvendit

\_\_\_\_\_